



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS  
DREJTORIA LIGJORE  
SEKTORI I PROCEDURAVE LIGJORE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE**

**Durrës, më 01.06.2026**

**PROCESVERBAL  
Tipi i kontratës – SHËRBIM  
*Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)***

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:**

“Mbikqyrje objekti: “Ndërtim godina njësisë administrative Katund i Ri (objekt i rindërtimit nga tërmeti)”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):** Shërbime për mbikëqyrje të ndërtimit- 71521000-6.

**VLERA E FONDIT LIMIT TOTAL:** 504,546.25 (pesëqind e katër mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë pik njëzet e pesë) Lek pa TVSH..

**Argumentimi:**

sipas Vendimit të Këshillit të Bashkiak nr.73, datë 23.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026, si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2026-2028”, konfirmuar bazueshmëria ligjore e tij nga Prefekti i Qarkut Durrës, sipas shkresës me lëndë: “Verifikim i ligjshmërisë së aktit” me nr.906/10 prot., datë 07.01.2026, protokolluar me tonën nr.59/2, datë 08.01.2026 e cila është një vlerë midis vlerës minimale dhe vlerës maksimale sipas VKM nr. 354 dt.11.05.2016, Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudimin si dhe shtojcës përkatëse, përlogaritur nga grupi i specifikimeve në zbatim të urdhrit Nr.170, datë 04/05/2026, e Nr.5865/1 prot., të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përlogaritjen e Vlerës Limit”

Afati i realizimit të punimeve është: 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Afati i realizimit të mbikëqyrjes së punimeve do të jetë i njëjtë me afatin e publikuar të realizimit të punimeve.

## **Argumentimi i llojit të prokurimit:**

Në zbatim të Vendimit të Komisionit Shtetëror Rindërtimit nr.117, datë 20.12.2024, të Ligjit Nr.97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e Ligjit, Nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”; Vendimit Nr. 225, datë 12.04.2021 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese, kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”, të ndryshuar; për këtë procedurë prokurimi u përdorën dokumentet standarde “Procedurë e përsheptuar – rindërtimi punë”, lloji i procedurës “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit) të konfirmuar nga Agjencia e Prokurimit Publik si më poshtë:

*Në lidhje me procedurat e prokurimit që zhvillohen në kuadër të procesit të rindërtimit, kuadri rregullator, përveç ligjit për prokurimin publik, përfshin Aktin Normativ nr.9/2019, të miratuar me Ligjin 97/2019, si dhe VKM Nr.225 datë 12.04.2021, me anë të të cilit janë miratuar dokumentet standarde të tenderit për këto procedura. Referuar këtyre dispozitave ligjore, hartimi i dokumentet standarde për procedurat e prokurimit për rindërtimin është kompetencë e Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, ndërkohë që APP publikon këto dokumente.*

*Për sa më sipër, autoritetet kontraktore, për procedurat e rindërtimit, do të zbatojnë VKM Nr.225 date 12.04.2021 dhe do të përdorin dokumentet standarde të tenderit të miratuara me këtë vendim, edhe pse në këto DST nuk parashikohet Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:
  - a. Përshkrimin e Ofertës, sipas *Shtojcës 3*;
  - b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas *Shtojcës 4*;
  - c. Sigurim oferte sipas *Shtojcës 5*;
  - d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas *Shtojcës 7*;
  - e. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas *Shtojcës 8*;
  - f. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës *Shtojcës 10*;
  - g. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale, sipas *Shtojcës 11*;
  - h. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

---

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 77, 83, 87 të LPP-së nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenin 29,30, të VKM - së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar..

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenin 41, pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe VKM nr. 225 datë 12.04.2021 "Për një ndryshim në vendimin nr.199, datë 04.03.2020 "Për miratimin e dokumentave standarte".

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 2 (dy) vitet e fundit financiare (2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenet 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Vlera e xhiros vjetore të kërkuar (jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit për të paktën një nga dy vitet e fundit) është vendosur në përpjesëtim të drejtë me fondin limit të procedurës, me natyrën dhe vëllimin e punimeve që parashikon kontrata: Mbikqyrje objekti: "Ndërtim godina njësisë administrative Katund i Ri (objekt i rindertimit nga termeti)". Kërkesa e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë është gjithashtu në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi, konkretisht me nenin 64 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata", të ndryshuar, dhe Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Përmes këtyre dispozitave garantohet që të dhënat e xhiros të jenë të certifikuara nga autoritetet tatimore dhe të pasqyrojnë realisht qëndrueshmërinë financiare të operatorit. Kërkesa është ligjërisht e bazuar, proporcionalisht e arsyeshme dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, duke siguruar që operatori ekonomik të ketë potencial të mjaftueshëm financiar për zbatimin pa vonesa dhe pa risk të kontratës

---

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit financiare: (2024, 2025), të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tri vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit", si dhe duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar"; Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar; kërkesave të ligjit Nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të ndryshuar. Ky kriter, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, siguron qëndrueshmëri financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Ky kriter është ligjërisht i bazuar, proporcional dhe në raport të drejtë me natyrën e objektit të kontratës, duke siguruar që kontrata të realizohet nga operatorë që kanë aftësi reale financiare dhe organizative për zbatimin me sukses të kontratës.*

**2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument, të lëshuar nga administrata e njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku ushtrojnë aktivitetin, që vërteton se kanë shlyer detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore për vitin e fundit financiar, përfshirë këstet e maturuara, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, si dhe akteve përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë këtë vërtetim.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin e fundit*

---

financiar, përfshirë kështu e maturuara, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Gjithashtu referuar dhe ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 74 të tij. Shlyerja e detyrimeve vendore siguron që operatori ekonomik të jetë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe të mos ketë detyrime të prapambetura ndaj administratës vendore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e një procedure publike, ku përzgjedhja e operatorit duhet të garantojë integritet të plotë financiar dhe administrativ. Ky kriter është ligjërish i bazuar, i arsyeshëm dhe në përputhje me parimet e integritetit dhe kontrollit fiskal që kërkohen për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në kontrata publike, duke siguruar që subjektet pjesëmarrëse të jenë kontribuues aktivë dhe të ndershëm në sistemin tatimor e vendor të Republikës së Shqipërisë.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si mëposhtë:

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar referuar fondit limit, bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

---

**Aftësitë teknike dhe profesionale te tjerat si me poshtë janë hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga:** “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, Nr.170, datë 04/05/2026, e Nr.5865/1 prot., të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”:

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e shërbimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

**Punime të Përgjithshme Ndërtimi:**

- a. NP – 1 *Punime gërmimi në tokë;*
- b. NP – 2 *Ndërtime civile e industriale;*

**Për punimet speciale të ndërtimit:**

- a. NS – 1 *Punime për prishjen e ndërtimeve;*
- b. NS – 2 *Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;*
- c. NS – 4 *Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknikendërtues;*
- d. NS – 12 *Impiante teknologjik, termik dhe kondicionimi*
- e. NS – 14 *Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV;*
- f. NS – 18 *Punime topogjeodezike.*

*Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi. Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë.*

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e*

---

*rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.*

*Licensat e mësipërme kërkohen në bazë të zbërthimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve, në zbatim të VKM, Nr. 42, Datë 16.1.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Sipas lidhjes Nr.2 dhe lidhjes Nr.4.*

**Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

## **II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Në hartimin e termave të referencës për objektin Mbikëqyrje e objektit: “Ndërtim godina njësisë administrative Katund i Ri (objekt i rindërtimit nga tërmeti)”, grupi i punës është mbështetur në dispozitat e V.K.M. nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe në Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011, që ndryshon Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”. Në përputhje me këto akte, mbikëqyrja duhet të kryhet nga persona fizikë ose juridikë të licencuar, të pajisur me certifikatë profesionale të vlefshme, të përzgjedhur përmes procedurës së prokurimit publik sipas të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Specifikimet teknike janë përgatitur për të garantuar mbikëqyrjen profesionale të procesit të rindërtimit, duke përfshirë kontrollin e zbatimit të projektit, cilësinë e materialeve dhe përputhshmërinë me normat teknike të ndërtimit. Përcaktimi që mbikëqyrja të zgjasë gjatë gjithë periudhës së punimeve dhe të përfundojë me dorëzimin e dokumentacionit teknik është në përputhje me kërkesat ligjore dhe siguron monitorim të vazhdueshëm të punimeve. Kështu, specifikimet teknike të përfshira në termat e referencës janë të justifikuara ligjërisht dhe teknikisht, pasi garantojnë cilësinë, sigurinë dhe zbatimin korrekt të projektit të rindërtimit.

Termtat e referencës dhe procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të hartuar, vendosur dhe përlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” janë bashkëngjitur. Shënim: *Në çdo kërkesë të preventivit ku është shënuar marka e materialit shtohet fjale “ekuivalente e saj”.*

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Termtat e referencës, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT.

---

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP ([www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)).

## **Njësia e Prokurimit**